**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**
**VU644-19-7843-5-2-1/C228**
**14 Nr. 1270/19**
**Dt. 21.11.2019**

# KONTRATË PUNE

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson **: Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejmë **PUNËDHËNËSI**) , dhe

2. **" Kopshti "sh.p.k.** me seli në **Vushtrri**, me **ARBK : 811336248**, të cilën e përfaqëson **z. Fatmir Kajtazi**, në tekstin e mëtejmë: **PUNËMARRËSI,**

, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:
**Renovimi dhe rregullimi i oborrit të QMF-1 në Vushtrri,** me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prokurimi Nr. | VU644 | 1 | 9 | 78 | 4 | 3 | 5 | 2 | 1 |
| Prokurimi Nr. | 644 | 1 | 9 | 1 | 2 | 6 | 5 | 2 | 1 |

**Neni 1 Lënda**

**Neni 1 Lënda**
Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Renovimi dhe rregullimi i oborrit të QMF-1 në Vushtrri** ,sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-19-128-521.**

1.1 **Afati i fillimit të punimeve është** 2 ( dy ) dite pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.
1.2 Afati i përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas afatit të përcaktuara në Kushtet e Veçanta të Kontratës, jo më gjatë se **30 ( tridhjetë )** ditë kalendarike nga data e fillimit të punimeve.
1.3 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.
1.4 Kryesi i punimeve do të penalizohet me shumën prej 0,10% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të kryerjes së punëve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **16.998,00€ ( gjashtëmbëdhjetmijnënqindnëntdhjetetetë/00 Euro).**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesa do të bëhet: **në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.**

**2.4 Shuma e pagesës në avans nuk aplikohet.**

2.5 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

**Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Marrëveshja e kontratës;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

(e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(f) Plani për menaxhimin e kontratës;

(g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe[1] në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

---

[1] Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Saranda Cakaj |
| **Pozita:** | Drejtoreshë për prokurim publik |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 21.11.2019 |
| **Vula:** | |

**Për Kontraktuesin:**

| | |
|---|---|
| **Emri:** | Fatmir Kajtazi |
| **Pozita:** | Përfaqësues i Kryesit të Punëve: " Kopshti "sh.p.k. - Vushtrri |
| **Nënshkrimi:** | |
| **Data:** | 21.11.2019 |
| **Vula:** | |

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normenë e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, 18, e jo në formatin ~~0%, 8% apo 18%~~
Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, Po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore

Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Parallogaritura. Punëkryesi duhet tia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim..Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale.

| *Nr.* | *Përshkrimi i pozicioneve* | *Njësia Matëse* | *Sasia* | *Çmimi për njësi pa TVSH* | *Norma e TVSH-së në %* | *Çmimi për njësi (me TVSh)-€* | *Totali (Pa TVSH)* | *TVSH* | *Totali (me TVSH)-€* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A** | **Renovimi i objektit të QMF-1** | | | | | | | | |
| 1 | Përgaditja e hapsirave para fillimit të punimeve, verifikimi I punimeve të parapara dhe organizimi I punimve në kordinim me stafin shtepiak dhe org . Mbikqyrës , nikosishte në qëdo dhomë të bëhet regjistrimi I inventarit dhe gjësendeve të cilat gjenden , në prezencën stafit mengjues të QMF 1. | Shërbim | 1.00 | 84.75 | **18.00** | **100.00** | 84.75 | 15.25 | **100.00** |
| 2 | Furnizmi me materjal të nevojshëm për masat mbrojtes të inventarit , dyshemeve gjësendeve tjera të cilat janë pjesë hapsirave te brendesin dhe të jashtëme te objektit | paushall | 1.00 | 84.14 | **18.00** | **99.29** | 84.14 | 15.15 | **99.29** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Gryrja e mureve në pjesët e dëmtuara në pjesët mbi bordurat , rrethë lavamanve dhe pjesë tjera të cilat verifikohën edhe gjatë ekzekutimit, materjali I gëryet të futet në kese të plastikës dhe transportohet në kontinjer I cili do të kontraktohet nga kopania për pastrim | m² | 100.00 | 0.42 | **18.00** | **0.50** | 42.37 | 7.63 | **50.00** |
| 4 | Furnizimi me materjal dhe lyrja me bazë e të gjitha pjesve të gryera më parë në dy shtresa | m² | 100.00 | 0.17 | **18.00** | **0.20** | 16.95 | 3.05 | **20.00** |
| 5 | Furnizmi me materajl dhe suvatimi I pjesve të me ngjites ne dy shtresa perfeshire edhe rrjete plastke te percaktuare nga org. mbikqyres . | m² | 100.00 | 3.39 | **18.00** | **4.00** | 338.98 | 61.02 | **400.00** |
| 6 | Furnizimi me materaj lyrja me baze ne dy shtresa e tërë sipërfaqës | m² | 6,010.30 | 0.08 | **18.00** | **0.10** | 509.35 | 91.68 | **601.03** |
| 7 | Ngjyrosja e siperfaqeve te mureve te brendshem me ngjyre ekologjike. Ngjyra duhet te jetë për ambiente te brendshëm e cila hollohet me ujë ÷10%, rezistente ne fërkim te thatë. Ngjyrosje bëhet mbi bazë dhe ne dy shtresa me ngjyre te caktuarë e aplikuar me rul apo brushe. Ngjyrat duhet te jenë me veti larese-pastruese dhe punohen ne akordim me standardin ISO 9001: 2000. Nyanca e caktohet nga org. mbikqyrës | m² | 6,010.30 | 0.51 | **18.00** | **0.60** | 3,056.09 | 550.10 | **3,606.18** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Furnizimi me materajl dhe ngjyrosja ( polikolor të kualiteti me lartë i verifikuarë me CE) i mureve te jashteme në pjesët e hyrjes në objekte me ngjyre për pjesën e jashtëme ne dy shtresa , nianca e percaktaure nga org. mbikqyres , ne kete pozcionë të përfshihën edhe skelet | m² | 312.00 | 0.85 | **18.00** | **1.00** | 264.41 | 47.59 | **312.00** |
| 9 | Furnizimi dhe lyerja e mureve te kthinave dhe koridoreve me ngjyre te yndyrshme ne lartesi h = 1.0 m' | m² | 165.00 | 1.69 | **18.00** | **2.00** | 279.66 | 50.34 | **330.00** |
| 10 | Thyrja e murit të brendshem në hapsiren e caktaurë me dimensione 4,2x3,15 x0,25materjali I demoluarë të vendoset në kese të plastikes dhe të hydhet në kontinjer | m² | 25.20 | 2.54 | **18.00** | **3.00** | 64.07 | 11.53 | **75.60** |
| 11 | Furnizimi me materjal me llaq vazhdues me perberje 1:3 parapakisht me spërkatje me llaq cimento , dhe gletimi I pjesës së harrnuarë I mureve në pjesët e demoluarë. | m² | 25.20 | 5.93 | **18.00** | **7.00** | 149.49 | 26.91 | **176.40** |
| 12 | Furnizimi me materjal dhe shtrurja e dyshemes me lielium t=4mm dhe bordura me lartësi t=8cm I aprovuarë nga org. mbikqyrës , në këtë pozcionë është I përfshirë edhe përgaditja e dyshemes në pjesën ku është thyer muri | m² | 2.50 | 21.19 | **18.00** | **25.00** | 52.97 | 9.53 | **62.50** |
| 13 | Demolimi I kubzave të betonit me kujdes me mundësi të kthimit në vendin e mëparshëm , në këtë pozcionë është I përfshirë edhe punet e shtrurje me te gjitha shtresat e nevojshme | m² | 12.00 | 4.24 | **18.00** | **5.00** | 50.85 | 9.15 | **60.00** |
| 14 | Gryrja me mjete dorë e themelit në thellësi h=1,5-1,8mdhe gjërsi b=1,40m materjali I gërmuara të planifikohet në vendin e caktaurë | m² | 8.40 | 50.85 | **18.00** | **60.00** | 427.12 | 76.88 | **504.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Furnizimi me materjal dh e shtrurja e gurit të thyer me trashësi 063mm për nivelizimin e fudit të themelit , në këtë pozcionë është përfshirë edhe ngjeshja e mjaftushme 80MP | m³ | 0.96 | 12.71 | **18.00** | **15.00** | 12.20 | 2.20 | **14.40** |
| 16 | Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i armaturave fije dhe rrjete sipas detaleve te projektit. Kualiteti i armaturës S-500B (fyk=500 MPa). Ne çmim te llogaritet edhe teli qe nevojitet për lidhje te armaturave dhe te gjitha punët e nevojshëm për ketë pozicion.<br>Llogaritet ne kilogram te montuar. | kg | 312.00 | 0.51 | **18.00** | **0.60** | 158.64 | 28.56 | **187.20** |
| 17 | Furnizimi me beton C-30/37 dhe punimi i themeleve të veçanta (Objekti ) duke përfshirë dhe zokulen sipas detaleve për ekzekutim. . Ne çmim të përfshihen edhe latimi, vibërimi Llogariten ne metër kub. | m³ | 4.80 | 50.85 | **18.00** | **60.00** | 244.07 | 43.93 | **288.00** |
| | **TOTALI A:** | | | | | | **5,836.10** | **1,050.50** | **6,886.60** |
| **B** | **Rregullimi i oborrit të QMF-1** | | | | | | | | |
| 1 | Pastrimi I terenit në tër gjëresin dhe gjatesin e hapsirës e dedikuarë për gjelbrim duke perfshir largimi e dheut deri ne deponin ku e cakton organi mbikqyres | m² | 257.00 | 0.42 | **18.00** | **0.50** | 108.90 | 19.60 | **128.50** |
| 2 | Germimi I dheut te kategoris se II dhe III sipas vendit, ne trashesi t=20cm ne llogari hyn dhe bartja deri ne deponi per ter gjatesin dhe gjeresine hapsirës e cila do të trajtohet | m² | 257.00 | 1.27 | **18.00** | **1.50** | 326.69 | 58.81 | **385.50** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Furnizimi me materjal prej gurit te thyer (0-31.5)mm me trashesi ne gjendje te ngjeshur t=10 cm ngjeshja te behet me rrul cilindrik duke perdorur edhe vibratorin MSH=80 MN/M2 në tërë gjatësin mbi të cilën vendoset guri skajorë | $m^3$ | 15.42 | 8.47 | **18.00** | **10.00** | 130.68 | 23.52 | **154.20** |
| 4 | Furnizimi me materjal dhe betoni I bazës ku do vendosen gurët skajorë me beton gysëm t ë terurë me MB25/30 I punuarë në vend me trashësi t=12cm | $m^3$ | 9.30 | 50.85 | **18.00** | **60.00** | 472.88 | 85.12 | **558.00** |
| 5 | Furnizimi dhe vendosja e skajorve me dim. 15/18/24m sidhe punimi I bazes me beton per vendosjen e tyre .( Atestet e Skajorve te prezentohen para fillimit te punimeve duhete plotesu kushetein e 25 cikluseve ) | m' | 312.00 | 4.66 | **18.00** | **5.50** | 1,454.24 | 261.76 | **1,716.00** |
| 6 | Furnizimi me materja dhe ngyrosja e gurve skajorë sipas kërkesë së org. mbikqyrës , në këtë pozcionë është përfshirë edhe punet e ngjyrosjes me bazë dhe ngyrë e dedikuarë për hapsira të jashtme. | m' | 312.00 | 0.42 | **18.00** | **0.50** | 132.20 | 23.80 | **156.00** |
| 7 | Furnizimi me material si dhe rregullimi i hapesires-parterit rreth gurve skajore me dimensione 0,5x514 (perpunimi i dheut, sjellja e dheut humusor ~20cm, | $m^3$ | 51.40 | 6.78 | **18.00** | **8.00** | 348.47 | 62.73 | **411.20** |
| 8 | Furnizimi me materjal dhe mbjellja , ujitja deri luleve) tw shumw llojsme | copë | 20,560.00 | 0.17 | **18.00** | **0.20** | 3,484.75 | 627.25 | **4,112.00** |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Furnizimi, transporti, mbjellja dhe mirembatja e drunjeve dekorative ne kuader te gjelbrimit te larte me lartesi 2-3m,Iloji I drurit CATALPA. Pema duhet të jetë I rrethuar me një gardh druri(pikat mbrojtëse trekëndsh) | copë | 100.00 | 21.10 | **18.00** | **24.90** | 2,110.17 | 379.83 | **2,490.00** |
| | **TOTALI B:** | | | | | | **8,568.98** | **1,542.42** | **10,111.40** |

# R E K A P I T U L I M I

| Nr. | Përshkrimi | Vlera me TVSH në € |
|---|---|---|
| A | **Renovimi i objektit të QMF-1** | 6,886.60 |
| B | **Rregullimi i oborrit të QMF-1** | 10,111.40 |
| | **TOTALI I PËRGJITHSHËM PA TVSH=** | **14,405.09** |
| | **TVSH=** | **2,592.92** |
| | **TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH = A+B:** | **16,998.00** |

| **IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)** | |
|---|---|
| **EMRI I OE:** | Kopshti SH.P.K. |
| **EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:** | Fatmir Kajtazi |
| **NËNSHKRIMI:** | |

| | |
|---|---|
| **DATA:** | 04.11.2019 |
| **VULA:** | |

Numri i prokurimit: **VU644-19-1907-5-2-1** apo nr. i brendshem: **VU644-19-024-521 Titulli: Renovimi i QMF-ve dhe instalimi i ngrohjeve me pelet**

# PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK |
|---|---|---|
| Përshkrimi i nenit | Neni. Nr. | |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha | 2.1 | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : **Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.** |
| | 2.2 | Gjuha e përdorur do të jetë : **gjuhët zyrtare në vend.** |
| Siguria e ekzekutimit | 10.1 | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës, në kohëzgjatje prej 60 ditë nga data e nënëshkrimit të kontratës e lëshuar nga një Bankë ose Kompani e sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2 | Shuma minimale e sigurimit do të jetë:<br>(a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve *[shëno shumat]*;<br>(b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve *[shëno shumat]*;<br>(c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën *[shëno shumat]*;<br>(d) dëmtim personal ose vdekje:<br>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit: *[shëno shumat]*<br>(ii) të personave të tjerë: *[shëno shumat]* |
| Programi | 12.1 | Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda **2 ( ditë )** ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. |
| | 12.2 | Periudha për Programin e azhurnuar është : konform planit dinamik të dorëzuar sipas afatit të përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë |
| Fillimi i punëve | 17.1 | Data e fillimit do të jetë : Një (1) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë. |
| | 17.2 | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas Planit Dinamik , por jo më gjatë se afat i përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë.<br>- fillimi i punimeve: : Një (1) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë. |
| Dëmet e likuiduara | 19.1 | Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0,10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës. |
| Regjistri i punës | 20.1 | Kontraktuesi – Kryesi i Punimeve dhe Menaxheri i Projektit - Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë Librin e Punës dhe Librin Ndërtimor, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përshkrimet e punimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar |

| | | |
|---|---|---|
| | | sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objekt – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e punimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të punimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve përmes të dhënave në shifra dhe data. |
| Inspektimi dhe testimi | 22.1 | Menaxheri i Projektit dhe Organi mbikëqyrës : do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës.<br><br>Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së punimeve në objekt, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe detyrat e përshkruara në vendimin mbi emërimin. |
| Parapagimi | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: **N / A** |
| Mbajtja e Parasë | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: **N / A** |
| Pagesat | 27.2 | Pagesat do të bëhen sipsa situacioneve të aprovuara nga organi mbikëqyrës si dhe raportit të lëshuar nga Menagjeri i kontratës.<br><br>Afati i pagesës brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit dhe evidentimit të faturës nga zyrtari përgjegjës për pranimi të faturave pranë Autoritetit Kontraktues. |
| Shkaqet për kompensim | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë : nëntëdhjetë ( 30) ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe fillimit të punimeve, konform Planit dinamik por jo më gjatë se Plani dinamik i përcaktuar në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë. |
| Përgjegjësia mbi Defektet | 34.5 | Periudha garantuese e defekteve është : Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objekt sipas Dokumentit - Policës së Sigurimit të kualitetit të punëve me afat të validitetit prej 13 muaj e lëshuar nga një Bankë ose Kompani e Sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës. |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : përqindja e vlerësuar e punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara. |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve | 42.2 | Komisioni për ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet **në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.** |